



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **63/2024**

Data: **22 Nëntor 2024. Ora: 14: 30**

Vendi: **Procedure qarkulluese e mbledhjes**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis,

Në takim ishin të pranishëm: Mufera Shinik

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

---

**2. Raport i Këshillave të KQZ**

---

**2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për format zgjedhore

2.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit dhe emërimi të anëtarit të KQZ-së në komunën e Zubin Potok

---

**2.2. Këshilli për Çështje Ligjore**

---

---

2.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Gjilan

---

### 2.3. Këshilli për Personel

---

### 3. Të ndryshme

---

#### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**Kreshnik Radoniqi:** E hapi mbledhjen 63, paraqiti agjendën e takimit. Arianit Elshani, paraqiti një pikë” miratimin e projektit për trajnimin e zyrtarëve të partive politike. Alban Krasniqi, propozoi pikën: shkatërrimi i materialeve 2012, 2013, 2014.

Me 9 vota për, miratohet rendi i ditës.

#### 2. Raport i Këshillave të KQZ:

##### Këshilli për Operacione Zgjedhore

###### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për format zgjedhore:

**Arianit Elshani:** Këshilli ka shqyrtuar këtë pikë, ku përfshihen të gjitha format zgjedhore, përfshirë edhe ato të përfaqësive diplomatike. Janë në kornet me rregullat tona, dhe shumë materiale janë nënshtruar debait në këshill. Rekomandojmë që të miratohen. Paramasa, është: 70,000 euro.

**Alban Krasniqi:** A vijnë në KQZ dizajnet, që ne ti miratojmë...?

**Arianit Elshani:** Po vijnë...!

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim.

###### 2. Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit dhe emërimi të anëtarit të KKZ-së në komunën e Zubin Potok:

**Arianit Elshani:** KOZ e ka shqyrtuar edhe këtë pikë. Është zëvendësim në KKZ. Kjo, është konform rregullores për nominim të anëtarëve të KKZ.

**Kreshnik Radoniqi:** Stanislava Vicentijeviq, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Zubin Potokut nga subjekti politik GISPO, duke e zëvendësuar Znj.Gordana Vucinić, nga i njëjti subjekt politik.

Me 9 vota për miratohet.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për trajnimin e e zyrtarëve të partive politike:**

**Arianit Elshani:** Ne, e kemi shqyrtuar edhe këtë pikë. Është një kërkesë edhe nga OSBE për organizimin e një punëtorie me dy sesione. Ka të bëj me modulën e regjistrimit dhe certifikimit të subjekteve politike në kuadër të softverit të KQZ. Mbështetet nga OSBE tërësisht. Çdo subjekt, të ketë nga dy persona të dërguar, kjo edhe është kërkesa jonë... Afati, është deri më 11 dhjetor. Moduli do të jetë për subjektet shqipfolëse, dhe moduli i dytë për subjektet tjera jo shqip folëse.

Me 9 vota për, miratohet projekti për trajnimin e zyrtarëve të partive politike.

### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i shkatërrimit të materialeve të periudhës 2012, 2013 dhe 2014 në QNR**

**Arianit Elshani:** Kemi shqyrtuar edhe rekomandimet që kanë ardhë si përgjigje nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës. Bëhet fjalë për materialet e ruajtura në QNR të periudhës zgjedhore të viteve 2012, 13 dhe 2014. Ai shpjegoi rrjedhën e këtij materiali, dhe tha se do të jetë një tender që do të shpallet për asgjësimin e këtij materiali.

ME 9 vota për, miratohet ky rekomandim

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtari të kuvendit komunal në Gjilan:

**Sami Hamiti:** Ne, në këshill e kemi shqyrtuar kërkesën dhe shkresat e bashkangjitura të kësaj kërkesë. Dhe, është verifikuar dhe konstatuar se kandidati i radhës në listën e rirenditur është z. Ganimet Sabedini. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit. I njëjti, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Gjilan nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal të deritashëm, z.Valdrin Bajrami. Këshilli, rekomandon këtë zëvendësim:

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për...? Atëherë, me 9 vota për Ganimet Sabedini, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z. Valdrin Bajrami.

### **3. Këshilli për Personel**

Raport mbi rekrutimin e grupit të katërt të stafit jo permanent:

**Alban Krasniqi:** Një pikë e shqyrtuar dhe e rekomanduar për mbledhje, ishte kërkesa për shpalljen e grupit të katërt të angazhimit të stafit jo permanent. Krahasuar me vitet e kaluara, ka rënë numri i të angazhuarve dhe kjo është pjesë më e lehtë e kostos materiale, dhe e planifikimit më të mirë. Të ketë koordinim mes të angazhuarve në mënyrë që stafi, të jetë i angazhuar. Z. Krasniqi, informoi se në cilat sektorë do të angazhohet grupi i katërt. Gjithsej, në këtë grup do të angazhohen: 169 pjesëtarë të stafit jo permanent.

**Kreshnik Radoniqi**: Miratohet edhe faza e katërt e grupit të stafit të angazhuar që do të meren në KQZ për procesin zgjedhor.

### **3. Të ndryshme !**